

LIGJ

Nr. 86/2019

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9975, DATË 28.7.2008, “PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 2, pika 5, shkronja “b”, shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Vlera e mjetit plotësohet në sistemin informatik të DPTSHRR-së, kur mjete regjistrohet për herë të parë ose/dhe sa herë ndryshon pronësia e tij. Vlera e mjetit, për efekt të klasifikimit “Automjet luksoz”, reduktohet çdo vit me 10 për qind të vlerës së mbetur.

Për automjetet të cilat shiten, vlera e shitjes së tyre, për efekt klasifikimi si “Automjet luksoz”, nuk mund të jetë më e vogël se vlera e mjetit të amortizuar, sipas paragrafit të mësipërm.”.

Neni 2

Nënenin 4, pika 3, bëhen këto ndryshime:

a) Fjalët “prej 5 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 25 për qind për çdo vit” zëvendësohen me fjalët “sipas nenit 114, të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

b) Fjalët “18 për qind” zëvendësohen me fjalët “25 për qind”.

Neni 3

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 7

Taksa që vilet nëpërmjet pullës

Taksa kombëtare, që vilet nëpërmjet pullës, është taksa e akteve të gjendjes civile.”.

Neni 4

Në nenin 8, pika 2, shkronja “g”, fjalët “0 (zero) për qind” zëvendësohen me fjalët “5(pesë) për qind”.

Neni 5

Në nenin 9, pika 1, shkronja “ç”, pas fjalëve “invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë” shtohen fjalët “personat me aftësi të kufizuara”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 18.12.2019.

Shpallur me dekretin nr. 11402, datë 30.12.2019, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.